

STATUT
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“ORGANIZATA E MENAXHIMIT TË PORTIT TË PESHKIMIT
DURRËS- OMPD “ SHPK

KREU I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja dhe Selia

Neni 1: Data e themelimit, Emri dhe Themeluesit

Sot më datë 8.06.2020, në mbështetje të legjislacionit shqiptar respektivisht Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare“ dhe Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, ne Ortaket e Shoqerise me pergjegjesi te kufizuar

“ORGANIZATA E MENAXHIMIT TË PORTIT TË PESHKIMIT
DURRËS- OMPD “ SHPK

formulojme Statutin e saj, si me poshte vijon,

Ortakët e shoqërisë janë:

1. **Qemal Beu**, i datëlindjes 10/01/1961, lindur dhe banues ne Durres, me numër identifikimi G10110270G
2. **Olsi Simsija**, i datëlindjes 26/10/1981, lindur dhe banues ne Durres, me numër identifikimi I11026126C
3. **Gjergj Luca**, i datëlindjes 30/08/1964, lindur dhe banues ne Durres, me numër identifikimi G40830079G
4. **Helidon Rruga**, i datëlindjes 12/08/1977, lindur dhe banues ne Durres, me numër identifikimi H70812052L
5. **Dorian Beu**, i datëlindjes 30/04/1979, lindur dhe banues ne Durres, me numër identifikimi H90430134I
6. **Syrjan Tola**, i datëlindjes 26/03/1980, lindur dhe banues ne Durres, me numër identifikimi I00326082M
7. **Skender Sali** i datëlindjes 04/01/1966, lindur dhe banues ne Durres, me numër identifikimi G60420235O
8. **Alban Bala**, i datëlindjes 20/04/1976, lindur dhe banues ne Durres, me numër identifikimi H60420235O
9. **Nazmi Kokomani**, i datëlindjes 26/11/1964, lindur dhe banues ne Durres, me numër identifikimi G41126083S

10. Klodjan Kapiti, l datelindjes 05/05/1977, lindur dhe banues ne Durrës me numer identifikimi H70505088N

Neni 2: Objekti

Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë si më poshtë:

- Menaxhimin e Portit të Peshkimit, menaxhimi l aktivitetit të peshkimit, burimeve peshkore
- Shërbimin për furnizim me karburant të anijeve të peshkimit, shërbim zjarrëfikës
- Zënie, Grumbullim, Përpunim dhe Tregtim me shumicë e pakicë të prodhimeve të detit, Brenda dhe jashtë vendit.
- Të realizojë e administrojë impiante të akuakulturës e të detikulturës ose të marrë me qera ekzistuese.
- Të realizojë e të administrojë impiante për mbledhjen, konservimin, mbingrirjen dhe transformimin e produkteve nga peshkimi (peshk, moluske, krustace, gasterpod etj.) me qëllim për të përmirsuar kushtet higjenosanitare për këto produkte.
- Kryerjen e operacioneve tregtare të eksportit të produkteve të peshkimit të sipërpërmendura, të importimit të produkteve itike të ngrira dhe ushqimeve në përgjithësi, për të plotësuar kërkesat në rritje të tregut shqiptar.
- Hapje të magazinave doganore
- Transport kombëtar dhe ndërkombëtar mallrash për vete, për të tretë e me qera.
- Shoqëria sipas nevojave të aktivitetit ka te drejtën e ushtrimit të cdo aktiviteti të ligjshëm, të lejueshëm për formën e shoqërisë, e cila nuk ndalohet me ligj (sipas nenit 7 të ligjit nr.9901, dt 14.04.2008).

Neni 3: Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat.

Neni 4: Sella

Selia do të jetë:

Lagjja 1, Autoriteti Portual, Godine tek Porti Peshkimit, Durres

Shoqeria mund te hape filiale, dege apo perfaqesi ne te gjithë territorin shqiptar dhe jashte vendit.

KREU II

Kapitali i regjistruar

Neni 5:Vlera dhe pagesat e kapitalit të regjistruar

Kapitali i shoqërisë është Lekë 100.000(njeqind mije) i ndarë në 10 kuota.

Kontributi i ortakëve në kapitalin e shoqërisë është vlerësuar sipas të dhënave të mëposhtme:

Qemal Beu, është zotërues i 1 kuote, me 10% pjesmarrje në kapitalin e shoqërisë ne vleren 10.000 leke

Olsi Simsija, është zotërues i 1 kuote, me 10 % pjesmarrje në kapitalin e shoqërisë ne vleren 10.000 leke.

Gjergj Luca, është zotërues i 1 kuote, me 10 % pjesmarrje në kapitalin e shoqërisë ne vleren 10.000 leke.

Helidon Rruga, është zotërues i 1 kuote, me 10 % pjesmarrje në kapitalin e shoqërisë ne vleren 10.000 leke.

Dorjan Beu, është zotërues i 1 kuote, me 10 % pjesmarrje në kapitalin e shoqërisë ne vleren 10.000 leke.

Syrjan Tola, është zotërues i 1 kuote, me 10 % pjesmarrje në kapitalin e shoqërisë ne vleren 10.000 leke.

Skënder Sali, është zotërues i 1 kuote, me 10 % pjesmarrje në kapitalin e shoqërisë ne vleren 10.000 leke.

Alban Bala, është zotërues i 1 kuote, me 10 % pjesmarrje në kapitalin e shoqërisë ne vleren 10.000 leke.

Nazmi Kokomani, është zotërues i 1 kuote, me 10 % pjesmarrje në kapitalin e shoqërisë ne vleren 10.000 leke.

Neni 6 : Pagesa e kuotave

Administratorët mund t'i kërkojnë ortakëve pagimin e kontributeve në para të pashlyera në lidhje me kuotat e tyre.

Në rast të mos shlyerjes së kontributeve, sipas përcaktimit të administratorit, personi përgjegjës do të paguajë një kamatë vonesë mbi shumën e papaguar me interes prej 4% në vit.

Neni 7: Kalimi I kuotave

Kalimi I kuotave dhe I të drejtave që rrjedhin prej tyre, mund të bëhet me:

Kontratë shitblerje,

Me dhurim,

Me trashëgimi ose me

Cdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Neni 8: Zmadhimi e zvogëlimi I kapitalit themeltar

Asambleja e Përgjithshme, me shumicë të kualifikuar, mund të zmadhojë kapitalin themeltar të shoqërisë duke rritur kuotat e ortakëve ekzistues në shumën e përcaktuar në vendimin përkatës. Zmadhimi I kapitalit me qëllim pranimin e ortakëve të rinj në shoqëri, miratohet nga Asambleja e Përgjithshme me shumicën e kualifikuar të votave të ortakëve.

Shoqëria mund të vendosë zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme, të marrë me shumicë të kualifikuar të votave.

KREU III

Neni 9: Të drejtat dhe detyrimet

Asambleja e Përgjithëshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë,
- b) Ndryshimet në statut,
- c) Emërimin dhe shkarkimin e administratorëve,
- d) Emërimin dhe shkarkimin e likuidatorëve dhe ekspertëve kontabel të autorizuar,
- e) Mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë,
- f) Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit,
- g) Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre,
- h) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve,
- i) Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë,
- j) Miratimin e rregullave proceduriale të mbledhjeve të asamblesë,
- k) Çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti,

Neni 10: Thirrja e Asamblesë së Përgjithëshme

- a) Asambleja e Përgjithëshme thirret nga administrator të paktën 2 herë në vit, për të miratuar përkatësisht bilancin vjetor të mbyllur dhe bilancin vjetor parashikues.
- b) Mbledhja e Asamblesë së Përgjithëshme thirret nëpërmjet një shkrese dërguar çdo ortakut me postë të zakonshme ose mesazh elektronik. Njoftimi duhet të kryhet të paktën 7 ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen
- c) Ortakët, që zotërojnë të paktën 5 % të kapitalit të regjistruar kanë të drejtë thërrasin mbledhjen e Asamblesë së Përgjithëshme nëpërmjet administratorit ose edhe pa ndërmjetësimin e tij.

Neni 11: Mbledhjet e Asamblesë Së Përgjithëshme

- a) Mbledhja e Asamblesë është e vlefshme nëse në të marrin pjesë ortakë që zotërojnë më shumë se 51 % të aksioneve, për të vendosur për çdo çështje të zakonshme. Në këtë rast vendimi i Asamblesë është i vlefshëm nëse është votuar nga shumica e voteve të ortakëve pjesëmarrës, (e cilësuar në këtë rast statut si shumicë e thjeshtë.)
- b) Mbledhja e Asamblesë, për të vendosur për çështje të vecanta si: ndryshimi i statutit, zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit të regjistruar, shpërndarja e fitimeve, riorganizimi

dhe prishja e shoqërisë, është e vlefshme nëse në të marrin pjesë ortakë që zotërojnë më shumë se 75 % të kuotave. Në këtë rast vendimi i Asamblesë është i vlefshëm nëse është votuar nga jo më pak se tre të katërtat e votive të ortakëve pjesëmarrës, (e cilësuar në këtë rast statyt si shumicë e kualifikuar)

- c) Mbledhja e Asamblesë drejtohet nga administrator nëse është thirrur prej tij. Nëse Asambleja e Përgjithshme është thirrur nga pakica, atëherë ajo kryhesohet nga njëri nga ortakët e zgjedhur nga pjesëmarrësit në atë mbledhje.
- d) Administratori pavarësisht se nuk është ortak, ka të drejtën e pjesëmarrjes si edhe të marri fjalën në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithëshme.

Neni 12: Votat e Pjesëmarrësve

- a) Çdo ortak ka të drejtë vote në përpjestim me vlerën nominale të kuotës së tij.
- b) Anjë ortak nuk voton në mbledhjen e asamblesë së përgjithëshme nëse nuk ka shlyer tërësisht detyrimet, që kanë të bëjnë me kuotat që ai disponon.

Neni 13: Emërimi i Administratorit

- a) Administrimi si përfaqësimi i shoqërisë i beson një Administratori të vetëm që mund të mos jetë ortak.
- b) Asambleja e Përgjithëshme zgjedh fillimisht, për një periudhë 5 vjecare një administrator, Z. Olsi Simsija
- c) Asambleja e Përgjithëshme mund të shkarkojë në çdo kohë Administratorin nga detyra, me shumicë të zakonshme votash, me kusht që në mbledhje të marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30% të kuotave.

Neni 14: Kompetencat e Administratorit

Administratori ka të drejtë dhe detyrohet:

- a) Të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare të vendosura nga Asambleja e Përgjithëshme,
- b) Të përfaqësojë shoqërinë
- c) Të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumentave dhe të librave kontabël të shoqërisë.

- d) Të bëjë të mundur përgatitjen ng specialist I ngarkuar dhe të nënshkruajë bilancin vjetor parashikues për vitin e ardhshëm, për tu miratuar nga Asambleja e Përgjithëshme, Brenda datës 20 tetor të vitit paraardhës.
- e) Të bëjë të mundur përgatitjen nga specialist I ngarkuar dhe të nënshkruaj bilancin vjetor të mbyllur, për tu miratuar nga Asambleja e Përgjithëshme, Brenda datës 20 mars të vitit të ardhshëm dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, I paraqet këto dokumente përpra Asamblesë së Përgjithëshme për miratim.
- f) Të krijojë një system monitorimi e njoftimi të hershëm për rrethanat që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë.
- g) Të kryejnë regjistrimet e publikimet të të dhënave të të dhënave të shoqërisë
- h) Të raportojnë përpara Asamblesë së Përgjithëshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimtarive të posacme me rëndësi të vecantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare
- i) Të kryejë detyra, të përcaktuara në ligj dhe statut.

Neni 15: Mbledhjet e Administratorit

Administratori kujdeset ëq në libra të posacëm të mbajë process verbalet e të gjitha takimeve të kryera nga ai, si dhe të gjitha mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme.

KREU VI

Shpërndarja e fitimit vjetor të shoqërisë

Neni 16: Shpërndarja e te ardhurave

- a) Pjesa më e madhe e të ardhurave do te pasqyrohet ne buxhet si investim I vazhdueshëm pergjate vitit, në Portin e Peshkimit Durrës.
- b) Pjesa e fitimit që I takon secilit ortak nga vlera e fitimit vjetor të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë, vendoset të shpërndahet nga Asambleja e Përgjithshme.
- c) Asambleja e Përgjithshme ka kompetencë t'u shpërndajë ortakëve pjesën e fitimit në raport me vlerën e kapitalit të regjistruar, që kuotat e secilit ortak përfaqësojnë.
- d) Po ashtu , Asambleja e Përgjithëshme mund të vendosë që një pjesë e fitimit vjetor të mos u shpërndahet ortakëve, por këto shuma të përdoren për zmadhimin e kapitalit fillestar apo për qëllime të tjera, të cilat ajo I konsideron të dobishme për shoqërinë.

KREU VII

Prishja dhe njoftimet

Neni 17: Prishja dhe likuidimi

- a) Në rast të likuidimit të shoqërisë, Asambleja e Përgjithëshme emëron një likuidator, i cili administron shoqërine deri në mbylljen e procesit të likuidimit.
- b) Me vendimin e posacëm të Asamblesë së përgjithëshme, të marrë me shumicë të kualifikuar, pasi janë shlyer detyrimet ligjore ndaj kreditorëve të shoqërisë, likuidatori shpërndan pjesën e mbetur të pasurisë së shoqërisë ndërmjet ortakëve. Kjo shpërndarje e fundit bëhet në raport me vlerën e kapitalit të regjistruar, qe kuotat e secilit ortak përfaqësojnë.

Neni 18: Ftesa për kreditorët

Likuiduesit duhet të ftojnë kreditorët për të depozituar pretendimet e tyre për prishjen e saj. Shoqëria e publikon dy herë këtë njoftim, me një interval prej 30 ditësh, në faqen e saj të internetit, si dhe në faqen e internetit të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit. Në njoftim duhet deklaruar se pretendimet duhet të depozitohen Brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të fundit.

Neni 19: Përfundimi I likuidimit

- a) Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Regjistrimit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon cregjistrim e shoqërisë .
- b) Veprimtaria e likuiduesit nuk mundt të kundërshtohet pas cregjistrimit të shoqërisë nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit.

Neni 20: Dispozitat e fundit

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me normat e këtij statute.

Për cdo gjë tjetër, që nuk është shkruar shprehimisht në këtë statut, zbatohet legjislacioni në fuqi për shoqërinë tregtare, për QKR-në si dhe cdo ligj tjetër mbi veprimtarinë e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar.

Ortakët e Shoqërisë

Qemal Beu



Olsi Simsija



Gjergj Luca




Helidon Rruga



Dorjan Beu



Syrjan Tola




Skender Sali



Alban Bala



Nazmi Kokomani



Klodjan Kapiti

